



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores MF – Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore , neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, si dhe Propozimit të Komisionit për vlerësimin e aseteve (gjedhave) i datës 07.11.2016, Kryetari i Komunes, nxjerr

V E N D I M
PËR SHITJEN E GJEDHAVE NË FERMËN E EKONOMISË SHKOLLORE TË SH.M.P
“ADEM GLLAVICA”

Neni 1

TË SHITEN, 2 (dy) gjedhat me Nr. KS10445664 dhe RKS11171345 që gjendet në fermën e ekonomisë shkollore të SH.M.P “Adem Gllavica” në Lipjan.

Neni 2

Obligohet Drejtorati për Arsim që menjëherë të fillojë iniciimin e procedurave të shitjes së gjedhave të cekur nëpërmjet procedurave të prokurimit publik - ankandit publik .

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Arsim dhe Drejtorati për Prokurim.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtoratit për Arsim dhe Drejtorati për Prokurim. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi anulohet Vendimi 1Nr.400-59892 i datës 26.10.2016.

1Nr. 400-61795
Lipjan, më 08.11.2016

